



## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 616-21-7469-2-2-5/C779

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njérën anë; dhe

**RIKO EKOS d.o.o., MALI LOG 2A, LOŠKI POTOK, SI31130348.** (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Kalibrimi i paisjeve në impiantin e kompostimit me numër identifikues: 616-21-7469-2-2-5**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

### Kalibrimi i paisjeve në impiantin e kompostimit

No.	<b>616 21 147 225</b>
1	<b>Kalibrimi i paisjeve në impiantin e kompostimit</b>

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **25 500,00 €**; (Njëzet e pesë mijë e pesëqind) Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues përfshirë edhe Specifikimet Teknikë; Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontraten konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e saturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

Neni 4

**Komunikimet**


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe , serbe dhe angleze <sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Nexham Mekollli
Pozita:	Zyrtar përgjegjes i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	22-03-2022
Vula:	

**Për Ofruesin e Shërbimeve**

Emri:	ALEŠ KNAUS
Pozita:	DIRECTOR
Nënshkrimi:	
Data:	29.3.2022
Vula:	

Mali Log 2a  
1318 Loški Potok

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tende0ruesit në këtë tender.

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-21-7469-2-2-5/C779

## Neni 1 Përkuqizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
  - a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implemëntimit te kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përm bushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushton brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë *madhore*" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrégullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vërtëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës *madhore* do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës *madhore*. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës *madhore*.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës *madhore* ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofriuesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës *madhore* të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofriuesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofriuesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofriuesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofriuesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofriuesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nationale;
- (e) Ofriuesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofriuesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofriuesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofriuesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofriuesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofriuesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruejë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofriuesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëshëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpresë kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të asërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnje detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të janë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrate.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënës në pjesën IV të kontratës.

## Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjetet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pas që të këtë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofresi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Ofresit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të janë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitet e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### Neni 18 Korrigimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofresi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofresi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të siperpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofresit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 21                    Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**Neni 22                    Dëmshpërbimi**

22.1 Ofroesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofroesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofroesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofroesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofroesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

### PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Siguria ekzekutimit	9.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% E VLERES SE KONTRATES ne afat prej 90 ditesh</b>
Sigurimi	10.1	Incotermini i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Programi ekzekutimit	11	N/A
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	DDP (Delivery Duty Paid)
Inspektimi dhe testimi	19.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe ne përputhje me Nenin 19 te Kushteve te Përgjithshme ne adresat e specifikuara ne Nenin 2.2 te Kontratës.
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues përfurnizimet e dorezuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.
Afat		<b>60 dite</b>
Obligimet garacionit	24.1	<b>365 dite</b>
	24.5	N/A
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<b>Komisioni per ndermjësim pranë Ministrise se Drejtësise</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> ose

		<p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmenyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--	--